
AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Star Real Estate” SHPK

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1.

KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.

1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**Star Real Estate**” Shpk në vijim e quajtur “Shoqëria”.

1.2. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2.

SELIA.

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Bajram Curri, P 1 Maji, sh 7 , k 1 ap ½ Tirane prona e regjistruar ne zk 8260 Vol 28 Fq 131.

2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose mbi transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund të hape zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3.

KOHËZGJATJA.


3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

NENI 4.

OBJEKTI I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

- Agjensi Imobiliare, projekttime, vlerësime.



- Blerje dhe dhënie me qera e ndërtesave. Blerje, shitje, shkëmbim, valorizim, tregtim i tokave dhe i ndërtesave
- Shërbime online marketing dhe software development

4.2 Për të arritur objektin te saj, Shoqëria, me vendim te Asamblesë mund te realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

4.3 Shoqëria, dhe me qëllim arritjen e objektit te saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryeje çdo veprim tregtar që do ta konsiderojë të nevojshëm.

KAPITALI.

PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

NENI 5.

KAPITALI THEMELTAR.

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 kuota. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 6.

ORTAKËT.

6.1 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët e shoqërisë :

- Dritan Rama, shtetas shqiptar, i lindur më datë 30.01.1984, në Tiranë identifikuar me nr.personal I40130204Q, madhor e me zotësi të plotë juridike



për të vepruar. Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë 50,000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

- Lorenc Sala, shtetas shqiptar, i lindur më datë 17.08.1980 , në Tiranë identifikuar me nr.personal I00817094L, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë 50,000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7.

TRANSFERIMI I KUOTAVE.

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme pa miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.

7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKB sipas parashikimeve ligjore.

NENI 8.

FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qellim arritjen e objektit te saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

NENI 9.

ORGANET E SHOQËRISË.

9.1 Organet e Shoqërisë janë:

- Administratori,
- Asambleja e Ortakëve.



NENI 10.

ADMINISTRATORËT

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 2 (dy) Administratore. Administratorët janë të autorizuar të kryejnë të gjitha veprimet tregtare të shoqërisë pa kufizim kompetencash, përveç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statuti ia ngarkon Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administratorët e shoqërisë kryejnë administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administratore:

- Znj. **Najada Mustafa**, shtetase shqiptare, e lindur më datë 07.11.1990, në Korce, identifikuar me nr.personal J06107019A, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Z. **Dritan Rama**, shtetas shqiptar, i lindur me date 30.01.1984 , ne Tirane, identifikuar me nr. Personal I40130204Q, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

10.3 Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Veprojnë në emër të shoqërisë dhe nënshkruajnë çdo dokument të shoqërisë. Administratorët nuk ushtrojnë kompetencat që ligji ose aktet e shoqërisë ja japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratorët emërohen për një afat 1-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

10.4 Administratorët mund të autorizojnë një person të kryejë veprim në QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjetër.

10.5. Administratorët përfitojnë shpërblim/pagesa për punën e tyre me në masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.

10.6. Administratorët kanë të drejtë ti delegojnë aksionerit të gjitha të drejtat sikur të ishte ai vet në lidhje me të gjitha institucionet financiare, drejtoritë e tatimeve, bankat etj .

NENI 11.



ASAMBLEJA E ORTAKËVE.

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje që ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë të detyrueshme të zbatohen nga organet e shoqërisë.

11.2. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe vendos në mënyrë të rregullt sipas kuorumit të parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht në selinë e shoqërisë por, me vendim të saj, Asambleja mund të mbledhet edhe në një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë të paktën 7 ditë përpara dhe duhet të marrin njoftimin për datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe të marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve mund të thirren nga Administratori/administratorët, ose nga subjekte të parashikuar në ligj.

NENI 12.

VITI FINANCIAR.

12.1. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe çdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

NENI 13.

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.



13.1. Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 99 01, date 22.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” zbatohet ne rastin e prishjes se shoqërisë.

13.2. Shoqëria prishet ne rastet e mëposhtëme: me vendim të asamblesë; me hapjen e procedurave të falimentimit; me vendim gjykate; dhe për çdo arsye tjetër parashikuar në akte të shoqërisë ose në legjislacionin shqiptar.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 14.


LIGJI I ZBATUESHËM.

14.1. Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar ne këtë statut do te zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, date 22.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.


14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet ne 5 kopje origjinale sot më 17. 9, 2021 në Tiranë.

ORTAKET

DRITAN RAMA



LORENC SALA



Administrator

Najada Mustafa

